



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2023:200088
Datë: 29.03.2024
Numri i dokumentit: 05523608

C.nr.1616/2023

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Florije Qerimi, në çështjen kontestimore të paditësit L H. nga fshati D., Komuna e G., të cilin me autorizim të dhënë nga Zyra Rajonale për Ndihmë Juridike Falas në Gjilan e përfaqëson av.Vlora Kadriu nga Gjilani, kundër të paditurit S. A. nga fshati D., komuna e Gj., me objekt kontesti Vërtetimi i të drejtës së pronësisë, me vlerë të kontestit 6,000.00 euro, jashtë seancës gjyqësore, me datë 19.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

NDËRPRITET PROCEDURA në këtë çështje kontestimore për shkak të vdekjes së të paditurit S. A. nga fshati D., komuna e Gj..

A r s y e t i m

Paditësi, përmes të autorizuarës së tij, më datë 19.09.2023 ka paraqitur padi në këtë gjykatë kundër të paditurit me objekt kontesti për Vërtetimin e pronësisë.

Kjo gjykatë, duke vepruar konform dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, nenit 394 dhe 395 të këtij ligji, të paditurit të lartcekur, në adresën e tyre i ka dorëzuar aktvendimin për përgjigje në padi së bashku me shkresat e lëndës, mirëpo nga fletëkthesa e datës 29.11.2023 konstatohet se pala është i vdekur. Lidhur me këtë fakt gjykata me datë 29.01.2024 ka bërë kërkesë për informatë Zyrës së Gjendjes Civile në Gjilan, nga të cilët me datë 30.01.2024 ka marrë përgjigje në kërkesë, se i padituri Sadik Adilovci është i regjistruar si i vdekur, duke ia bashkangjitur edhe Certifikatën e vdekjes së të njëjtit.

Sipas nenit 277, paragrafi 1, pika a) të LPK-së lidhur me nenin 18 të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e LPK-së, është paraparë se në rastet kur pala ndërgjyqëse vdes ose e humbë zotësin procedurale, procesi gjyqësor ndërpritet, ndërsa me nenin 280, paragrafi 1 të po këtij ligji është paraparë se procedura që është ndërprerë për shkaqe të treguara në nenin 277, paragrafi 1, pika a) dhe d) të këtij ligji do të vazhdohet kur trashëgimtari, apo kujdestari i pasurisë trashëgimore, përfaqësuesi i ri ligjor, administratori i falimentimit apo pasardhësi juridik i personit juridik, e marrin përsipër procedurën apo kur i thërret gjykata ta bëjnë këtë, me propozimin e palës kundërshtare.

Në rastin konkret rezulton se i padituri sipas kësaj çështje kontestuese ka vdekur dhe si rrjedhojë, në bazë të të cekurave më lartë, procedura duhet ndërprerë (neni 277, paragrafi 1, pika a) i LPK-së).

Nga të cekurat më lartë u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
C.nr.1616/2023, me datë 19.03.2024

Gjyqtarja,
Florije Qerimi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi lejohet ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marjes së aktvendimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kesaj gjykate.